

Statistikat e transportit*

Nëntor 2021

Tiranë, më 24 Dhjetor 2021: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Nëntor 2021 është 375,0 mijë ton, duke u ulur 11,9 %, krahasuar me Nëntor 2020.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2021, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 4.465,4 mijë ton, duke u rritur me 13,9 %, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020. Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është rritur me 8,9 %, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019.

Në muajin Nëntor 2021, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 1.383 mijë ton-kilometër, duke u ulur me 40,9 %, krahasuar me Nëntor 2020.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2021, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 23.477 mijë ton-kilometër, duke u rritur me 0,9 %, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020. Krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është ulur me 41,5 %.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Transporti i mallrave		
	Me det / ton	Hekurudhë 000/ton.km	Ajër / ton *
Nëntor 2020	425.571	2.339	159,4
Nëntor 2021	374.958	1.383	190,4
Ndryshimi vjetor (%)	-11,9	-40,9	19,5
Janar-Nëntor 2019	4.100.646	40.112	2.124,6
Janar-Nëntor 2020	3.919.039	23.279	1.616,7
Janar-Nëntor 2021	4.465.410	23.477	1.835,8
Ndryshimi vjetor progresiv 2021/2020 (%)	13,9	0,9	13,6

* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në muajin Nëntor 2021, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 190,4 ton, duke u rritur 19,5 %, në krahasim me Nëntor 2020.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2021, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 1.835,8 ton duke u rritur me 13,6 %, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020. Krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019, volumi i mallrave të transportuara me ajër është ulur me 13,6 %.

Për publikim 24/12/2021

Vijon

* Ky publikim nuk përfshin volumin e mallrave dhe numrin e pasagjerëve të transportuar nëpërmjet transportit rrugor.

Në Nëntor 2021, numri i fluturimeve të kryera është 2.124, duke u rritur 70,5 %, në krahasim me Nëntor 2020.

Tab. 2 Treguesit specifike të transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore*	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Nëntor 2020	14	1.246	4.237
Nëntor 2021	19	2.124	9.299
Ndryshimi vjetor (%)	35,7	70,5	119,5
Janar-Nëntor 2019	17	26.365	177.757
Janar-Nëntor 2020	14	14.226	82.414
Janar-Nëntor 2021	19	23.926	118.805
Ndryshimi vjetor progresiv 2021/2020 (%)	35,7	68,2	44,2

*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat janë licencuar të kryejnë fluturime në fillim të vitit

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në Nëntor 2021, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 33.881 pasagjerë. Krahasuar me Nëntor 2020, ky tregues është rritur 61,2 %.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2021, kanë udhëtuar me linjë detare 803.657 pasagjerë, duke u rritur me 2,3 herë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020. Krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linjë detare është ulur me 46,3 %.

Në muajin Nëntor 2021, transporti ajror i pasagjerëve zë 86,8 % të transportit gjithsej.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në Nëntor 2021 është pasagjerë duke u rritur me 3,1 herë, krahasuar me Nëntor 2020.

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2021, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 2.656.935 pasagjerë duke u rritur me 2.2 herë, krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2020. Krahasuar me njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linjë ajrore është ulur me 13,4 %.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Nëntor 2020	562	21.013	73.065
Nëntor 2021	1.031	33.881	229.904
Ndryshimi vjetor (%)	83,5	61,2	214,7
Janar-Nëntor 2019	59.530	1.495.495	3.066.488
Janar-Nëntor 2020	17.523	344.660	1.224.874
Janar-Nëntor 2021	23.252	803.657	2.656.935
Ndryshimi vjetor progresiv 2021/2020 (%)	32,7	133,2	116,9

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/>

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Nëntor 2021, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 117,8 mld lekë dhe 47,3 % e tyre u transportua me det. Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2021, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 1.032,7 mld lekë dhe 48,5 % e tyre u transportua me det. Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2019, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 870,5 mld lekë dhe 52,0 % e tyre u transportuan me det.

Eksportet e mallrave

Në Nëntor 2021, mallrat e eksportuara me det zënë 56,3 %, me rrugë 39,6 % dhe me ajër 0,5 %. Mallrat e eksportuara me rrugë në Nëntor 2021 janë rritur me 29,7 %, krahasuar me Nëntor 2020.


Tab.4 Eksporti i mallrave sipas mënyrave të transportit

Periudha	Eksport (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudhë	Me rrugë	Me ajër	Të tjera
Nëntor 2020	15.244	0	11.393	90	637
Nëntor 2021	20.987	0	14.782	188	1.349
Ndryshimi vjetor 2021/2020 (%)	37,7	-	29,7	110,2	111,9
Janar-Nëntor 2019	163.688	4	108.497	1.297	3.403
Janar-Nëntor 2020	139.900	5	107.948	1.103	4.268
Janar-Nëntor 2021	181.382	1	129.609	1.502	20.017
Ndryshimi vjetor progresiv 2021/2020 (%)	29,7	-71,3	20,1	36,1	369,1

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritje të INSTAT

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2021, mallrat e eksportuara me det zënë 54,5 %, me rrugë 39,0 % dhe me ajër 0,5 %. Mallrat e eksportuara me rrugë janë rritur 20,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020. Krahasuar me po të njëjtën periudhë të vitit 2019, mallrat e eksportuara me rrugë janë rritur 19,5 %.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Nëntor 2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritje të INSTAT

Importet e mallrave

Në Nëntor 2021 mallrat e importuara me det zënë 43,2 %, me rrugë 40,8 % dhe me ajër 2,5 %.

Mallrat e importuara me rrugë në Nëntor 2021 janë rritur me 23,3 %, krahasuar me Nëntor 2020.


Tab.5 Importi i mallrave sipas mënyrave të transportit

Periudha	Import (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudhë	Me rrugë	Me ajër	Të tjera
Nëntor 2020	25.720	233	26.611	1.715	1.476
Nëntor 2021	34.777	122	32.823	2.034	10.762
Ndryshimi vjetor 2021/2020 (%)	35,2	-47,6	23,3	18,6	629,1
Janar-Nëntor 2019	288.618	4.021	257.895	18.674	24.385
Janar-Nëntor 2020	260.185	2.645	262.941	16.050	14.719
Janar-Nëntor 2021	319.420	2.018	322.549	25.736	30.503
Ndryshimi vjetor progresiv 2021/2020 (%)	22,8	-23,7	22,7	60,3	107,2

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Në njëmbëdhjetëmujorin e vitit 2021, mallrat e importuara me rrugë zënë 46,1 %, me det 45,6 % dhe me ajër 3,7 %. Mallrat e importuara me rrugë janë rritur me 22,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020. Mallrat e importuara me rrugë janë rritur me 25,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Nëntor 2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje të INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues dhe përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash